

VENDIM
Nr. 10, datë 26.2.2014

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E
RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”**

*(Ndryshuar me vendimet nr. 20, datë 4.3.2015; nr. 50, datë 1.7.2015; nr. 23, datë 1.4.2020; nr.
53, datë 2.9.2020; nr. 32, datë 2.7.2025)*

(i përditësuar)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 57, pika 2, nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 31, datë 30.4.2008 “Për miratimin e rregullore “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave””, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 dhjetor 2014.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
**PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË
BANKAVE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i kriterëve për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ndërmjet tyre ose me bankën, për qëllim të administrimit të rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe
- b) nenit 57, pika 2 të nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4
Përkufizime

(Ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (këtu e më poshtë për thjeshtësi rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit).

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “ekspozime ndaj një skeme” janë ekspozimet që klasifikohen, sipas rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, në klasat e mëposhtme të ekspozimit:

- i. ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization);
- ii. ekspozime në formën e kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- iii. zëra të tjerë.

b) “person i paidentifikuar” është një person i vetëm hipotetik, të cilit banka i cakton të gjitha ekspozimet, për të cilat nuk arrin të identifikojë debitorin, siç parashikohet në aneksin 1 të kësaj rregulloreje;

c) “kundërparti qendror e kualifikuar” është një subjekt që është licencuar për të operuar si një kundërparti qendror, nga autoritetet përkatëse mbikëqyrëse dhe rregullatore. Kundërpartia qendrore e kualifikuar krijohet dhe mbikëqyret në mënyrë të kujdesshme në një juridiksion, ku rregullatori/mbikëqyrësi përkatës ka hartuar dhe zbaton në mënyrë të vazhdueshme për kundërpartinë qendrore, rregulla që janë në përputhje me parimet ndërkombëtare për infrastrukturën e tregjeve financiare;

d) “banka me rëndësi sistemike” janë bankat e licencuara dhe që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara si të tilla, sipas vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë, bazuar në rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit.

KREU II
LLOGARITJA E EKSPOZIMEVE TË MËDHA

Neni 5
Ekspozimet

(Ndryshuar pika 2 dhe 7, shtuar pika 2/1 dhe 2/2, ndryshuar shkronja “c” e pikës 10, shtuar shkronja “d” në pikën 10 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi, grupi personash të lidhur ose një pale të tretë, llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Bankat, në rastet kur janë të detyruara të llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e tregut, në përputhje me kreun VII të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, përcaktojnë edhe vlerën e ekspozimeve në zërat e librit të tregtueshëm dhe ekspozimin në tërësi (ekspozimin e përgjithshëm), ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, sipas

nenit 165 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

a) bankat netojnë/kompensojnë pozicionet në blerje (long) dhe në shitje (short) për të njëjtin emetim¹. Në këtë mënyrë, bankat do të konsiderojnë pozicionin neto në një emetim specifik, për qëllime të llogaritjes së ekspozimit të bankës ndaj një kundërpartie të veçantë;

b) bankat netojnë/kompensojnë pozicionet në blerje (long) dhe në shitje (short) në emetime të ndryshme nga e njëjta kundërparti (i njëjti emetues), vetëm nëse pozicioni në shitje ka një nivel më të ulët përparësie (më junior) se pozicioni në blerje ose nëse pozicionet kanë të njëjtën përparësi (senioritet);

c) për pozicionet e mbrojtura nga derivativët e kredisë, bankat njohin mbrojtjen vetëm nëse mbrojtja dhe pozicioni i mbrojtur përmbushin kushtin e shkronjës “b”;

d) për të përcaktuar përparësinë (senioritetin) relative të pozicioneve, bankat i kategorizojnë titujt në shporta (buckets) më të gjera, sipas nivelit të përparësisë (për shembull: “Kapital”, “Borxh i varur” dhe “Borxh me përparësi të lartë (senior)”). Nëse bankat e kanë të vështirë ndarjen e titujve në shporta (buckets) të ndryshme bazuar në përparësinë relative, ato nuk i netojnë/kompensojnë pozicionet në blerje dhe në shitje në emetime të ndryshme që lidhen me të njëjtën kundërparti, për qëllime të llogaritjes së ekspozimeve;

e) në rastin e pozicioneve të mbrojtura nga derivativët e kredisë, për çdo reduktim të njohur nga banka në ekspozimin ndaj kundërpartisë origjinale, si pasojë e një teknike të pranueshme të zbutjes së rrezikut të kredisë, bankat njohin një ekspozim të ri ndaj ofruesit të mbrojtjes së kredisë. Shuma e ekspozimit të caktuar për ofruesin e mbrojtjes së rrezikut të kredisë është sa shuma me të cilën reduktohet ekspozimi ndaj kundërpartisë origjinale (përveç rasteve të përcaktuara në shkronjën “F” të kësaj pike);

f) nëse mbrojtja e kredisë merr formën e një credit default swap dhe ofruesi i mbrojtjes ose subjekti referencë nuk është një institucion financiar, shuma që do t’i caktohet ofruesit të mbrojtjes së kredisë nuk është shuma me të cilën reduktohet ekspozimi ndaj kundërpartisë origjinale, por është vlera e ekspozimit të rrezikut të kredisë së kundërpartisë, e llogaritur sipas kreut VI të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për qëllime të kësaj shkronje, në institucionet financiare përfshihen:

i.) institucionet e mbikëqyrura, siç përcaktohen në nenin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit; dhe

ii. institucione të tjera financiare, të ndryshme nga ato të parashikuara në nënpikën “i”.

2/1. Bankat nuk netojnë/kompensojnë midis pozicioneve në shitje (short) në librin e tregtueshëm dhe pozicioneve në blerje (long) në librin e bankës.

2/2. Nëse rezultati i netimit/kompensimit është një pozicion neto në shitje me një kundërparti të vetme, kjo vlerë (ky ekspozim) neto nuk duhet të konsiderohet si një ekspozim për qëllime të përlllogaritjes së ekspozimeve të mëdha.

3. Bankat llogarisin ekspozimin në tërësi ndaj një personi ose një grupi personash të lidhur, si shumë e ekspozimeve në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm.

4. Ekspozimi ndaj një grupi personash të lidhur është shuma e ekspozimeve ndaj personave, që përbëjnë grupin e personave të lidhur.

5. Bankat, në përcaktimin e grupit të personave të lidhur, në rastin e ekspozimeve ndaj një skeme, vlerësojnë skemën si një të tërë, ekspozimet bazë ose së bashku (skemën dhe ekspozimet).

6. Bankat, në zbatim të kërkesave të pikës 5 të këtij neni, vlerësojnë natyrën ekonomike dhe rreziqet që mbart struktura e transaksionit, dhe përdorin një nga mënyrat e përcaktuara në aneksin 1, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

7. Bankat, në llogaritjen e vlerës së ekspozimit në librin e bankës, marrin në konsideratë vlerën kontabël për zërat e aktivitetit (vlerën në bilanc pas zbritjes së fondeve rezervë për

¹ Dy emetime do të konsiderohen si “të njëjtë”, nëse emetuesi, kuponi, monedha dhe maturiteti janë të njëjtë.

mbulimin e humbjeve) dhe vlerën e zërave jashtë bilancit (pas aplikimit të përqindjeve të parashikuara në nenin 9, pika 1 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit), përpara ponderimit me peshat e rrezikut.

8. Bankat, në llogaritjen e vlerës së ekspozimeve që rrjedhin nga instrumente derivative, të përcaktuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, përdorin një nga metodat e përcaktuara në kreun VI të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit (rreziku i kredisë së kundërpartisë).

9. Bankat, pavarësisht përcaktimeve të mësipërme të këtij neni, nuk konsiderojnë si pjesë të ekspozimit, zërat që përbëjnë elemente zbritëse të kapitalit rregullator të bankës.

10. Bankat, pavarësisht përcaktimeve të mësipërme të këtij neni, nuk përfshijnë në llogaritjen e ekspozimit:

a) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transaksioneve të këmbimit valutor, që krijohen gjatë aktivitetit normal të shlyerjes, përgjatë dy ditëve pune;

b) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transaksioneve të shitblerjes së letrave me vlerë, që krijohen gjatë aktivitetit normal të shlyerjes përgjatë pesë ditëve pune të kryerjes së pagesës ose dorëzimit të letrës me vlerë, cilado qoftë më e hershme;

c) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transfertave të parave, përfshirë ekzekutimin e shërbimeve të pagesave, klerimin dhe shlyerjen në monedha të ndryshme dhe banka të ndryshme korrespondente ose klerimin, shlyerjen dhe shërbimet e marrjes në kujdestari të instrumenteve financiare për klientët, faturat e vonuara në financim dhe ekspozime të tjera që krijohen nga veprimtaria e klientëve, që nuk zgjatën më shumë se dita pasuese e punës, si dhe.

d) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transfertave të parave, përfshirë ekzekutimin e shërbimeve të pagesave, klerimin dhe shlyerjen në monedha të ndryshme dhe banka të ndryshme korrespondente, që krijohen brenda ditës ndaj institucioneve që ofrojnë këto shërbime.

Neni 6

Ekspozimet e mëdha

(Ndryshuar fjalë në pikën 2 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi ose grupi personash të lidhur mes tyre ose me bankën, konsiderohet i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10 për qind e kapitalit rregullator të saj.

2. Bankat llogarisin ekspozimet e mëdha, përpara aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë dhe përjashtimeve apo reduktimeve, të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

KREU III

LLOGARITJA E EKSPOZIMEVE MAKSIMALE

Neni 7

Ekspozimi maksimal i lejueshëm

(Shtuar pika 1/1, ndryshuar fjalë në pikën 2, ndryshuar pika 3 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Bankat respektojnë në çdo kohë kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh, të përcaktuar në nenin 64 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, si dhe kufizimet në lidhje me dhënien e kredive të përcaktuara sipas nenit 131 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

1/1. Ekspozimi i një banke me rëndësi sistematike ndaj një banke tjetër me rëndësi sistematike dhe grupit të personave të lidhur me të, subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar të

Bankës së Shqipërisë, nuk mund të tejkalojë 15 për qind të kapitalit të nivelit të parë të saj (bankës).

2. Bankat llogarisin ekspozimin maksimal të lejueshëm pas aplikimit të teknikave të zbutjes dhe përjashtimeve apo reduktimeve, siç përcaktohet në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli Drejtues i bankës përcakton rregulla të veçantë për ekspozimet ndaj personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën, përfshirë edhe dhënien e kredive, për monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të tyre.

Neni 8

Përjashtimet dhe reduktimet

(Shtuar shkronja "o" në pikën 2 me vendimin nr. 20, datë 4.3.2015; shtuar shkronja "p" me vendimin nr. 50, datë 1.7.2015; ndryshuar fjalë në shkronjën "b" të pikës 2, ndryshuar fjalë në shkronjën "i" të pikës 2, ndryshuar shkronja "j" e pikës 2, shfuqizuar shkronja "k" e pikës 2, ndryshuar shkronja "m" e pikës 2, ndryshuar shkronja "n" e pikës 2, shfuqizuar shkronja "o", shfuqizuar pika 3, shtuar pika 4 3 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020; shtuar shkronja "q" në pikën 2 me vendimin nr. 32, datë 2.7.2025)

1. Bankat, në rastet kur përdorin mbrojtjen e financuar apo të pafinancuar të kredisë, e cila rezulton në përjashtimin, tërësisht ose pjesërisht, të një ekspozimi apo në reduktimin e tij, duhet të plotësojnë kërkesat e njohjes dhe të gjitha kërkesat minimale siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit (përfshirë këtu dhe derivativët e kredisë, por duke përjashtuar *credit linked notes*).

2. Bankat, në llogaritjen e ekspozimeve maksimale të lejueshme, përjashtojnë, tërësisht ose pjesërisht, ekspozimet e mëposhtme:

a) ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore, të cilave u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare dhe bankave shumëpalëshe (multilaterale) të zhvillimit, të cilave u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

c) ekspozimet e garantuara shprehimisht nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, organizatat ndërkombëtare, bankat shumëpalëshe (multilaterale) të zhvillimit apo njësi të sektorit publik, në kushtet kur ekspozimeve të ofruesit të garancisë, u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

d) ekspozimet e tjera, që mund të klasifikohen si ekspozime ndaj njësive të përcaktuara në shkronjën "c" të këtij paragrafi apo që janë të garantuara nga njësitë e përcaktuara në shkronjën "c" të këtij paragrafi, kur ekspozimeve ndaj njësive të tilla u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

e) ekspozimet ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale apo autoritetet lokale, të cilave u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

f) ekspozimet e tjera, të siguruara me kolateral, në formën e depozitave, të vendosura në bankën që llogarit ekspozimin, ose filialin e saj apo bankën-mëmë të saj, si edhe:

i) *cash*-i i pranuar në rastin e lëshimit të *credit-linked notes* të lëshuara nga banka; dhe

ii) kreditë e dhëna nga banka dhe depozitat me bankën, që janë subjekt i netimit të zërave në bilanc, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

g) ekspozime të tjera të siguruara me kolateral, në formën e certifikatave të depozitës, të emetuara dhe të regjistruara nga banka që llogarit ekspozimin, ose filiali i saj apo banka-mëmë e saj; h) ekspozimet që lindin nga angazhime kredie të patërhequra, që janë të klasifikuara si zëra jashtë bilancit pa rrezik (aneksi 2 i rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit), me kusht që të jetë nënshkruar një marrëveshje apo kontratë, në bazë të së cilës fondet nuk mund të tërhiqen, nëse tërheqja e fondeve do të shkaktonte tejkalim të limiteve,

të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje;

i) ekspozimet ndaj kundërpartive qendrore të kualifikuara dhe kontributet e fondeve për mbulimin e humbjeve ndaj kundërpartive qendrore të kualifikuara;

j) ekspozimet, me jo më shumë se 80% të vlerës së tyre, në formën e obligacioneve të garantuara, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 26 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

k) Shfuqizuar;

l) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale të shteteve anëtare të BE-së, të cilave do t'u caktohet një peshë rreziku prej 20% dhe ekspozime të tjera ndaj apo të garantuara nga qeveritë rajonale apo autoriteteve lokale të shteteve të BE-së, të cilave do t'u caktohet një peshë rreziku prej 20%;

m) kur kundërpartia e bankës është banka e saj mëmë, një filial tjetër i bankës mëmë, filiali i saj (bankës) ose një institucion financiar, ku banka zotëron pjesëmarrje influencuese, banka redukton ekspozimet, bazuar në peshën e rrezikut të caktuar për kundërpartinë, në përputhje me kreun III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas përqindjeve të mëposhtme:

i. me jo më shumë se 80% të vlerës së ekspozimeve, nëse kundërpartisë i caktohet një peshë rreziku 20%;

ii. me jo më shumë se 60% të vlerës së ekspozimeve, nëse kundërpartisë i caktohet një peshë rreziku 50%;

iii. me jo më shumë se 40% të vlerës së ekspozimeve, nëse kundërpartisë i caktohet një peshë rreziku 100%,

dhe nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

iv. kundërpartia është një bankë apo institucion i mbikëqyrur, i themeluar në Shqipëri, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në një vend të tretë me kriteret rregullatore dhe mbikëqyrëse, të paktën të barasvlershme me ato të Bankës së Shqipërisë,

v. kundërpartia është e përfshirë në të njëjtën mbikëqyrje të konsoliduar të Bankës së Shqipërisë, si edhe banka ose është pjesë e të njëjtit grupi bankar/financiar të huaj ku banka bën pjesë; dhe

vi. ekspozimet ndaj kësaj kundërpartie nuk janë pjesë e kapitalit rregullator të saj (kundërpartisë);

n) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, që krijohen dhe rrjedhin nga zërat jashtë bilancit me rrezik të ulët, në formën e kredive dokumentare, në të cilat dërgesa ose malli (commodity) shërben si kolateral dhe angazhimeve të patërhequra të kredive, siç parashikohen në aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

o) Shfuqizuar.

p)² ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj.

q) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, siç parashikohet në nenin 19/2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

3.Shfuqizuar.

4. Bankat nuk mund të përdorin njëkohësisht dy përjashtime apo reduktime të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, për të njëjtin ekspozim.

² Ndryshimet sipas shkronjës "a" të paragrafit 1 janë të vlefshme për një periudhë kohore deri në datën 1 janar 2021.

Neni 9

Ekspozimet e siguruara me garanci ose me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë (metoda e zëvendësimit)

(Ndryshuar emërtimi i nenit, ndryshuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 2, ndryshuar fjalë në shkronjën "c" të pikës 2, ndryshuar fjalë në shkronjën "c" të pikës 3 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Bankat, në rastet kur ekspozimi ndaj një personi garantohet nga një palë e tretë, mund të trajtojnë / konsiderojnë pjesën e garantuar të ekspozimit si ekspozim ndaj garantuesit, vetëm në rast se, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit, ekspozimeve të pasiguruara të garantuesit do t'u caktohej një peshë rreziku e barabartë ose më e vogël sesa pesha e rrezikut që i caktohet një ekspozimi të pasiguar të personit/klientit.

2. Bankat, në llogaritjen e ekspozimit ndaj garantuesit (në rastet kur zbatojnë trajtimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni), konsiderojnë kriteret e mëposhtme:

a) Nëse garancia është shprehur në një monedhë të ndryshme nga ajo e ekspozimit, shuma e ekspozimit të mbuluar (garantuar) llogaritet në përputhje me dispozitat për trajtimin e mospërputhjes së monedhave në rastin e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) Nëse ekziston një mospërputhje midis maturitetit të ekspozimit dhe maturitetit të garancisë, kjo trajtohet në përputhje me dispozitat për trajtimin e mospërputhjes së maturitetit, siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit; si dhe

c) Nëse mbulimi është i pjesshëm, njohja (recognition) e pjesshme e garancisë realizohet siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

3. Bankat, në rastet kur ekspozimi ndaj një personi sigurohet me një kolateral të njohur, të lëshuar nga një palë e tretë, mund të trajtojnë/konsiderojnë pjesën e siguar/kolateralizuar të ekspozimit, si ekspozim ndaj emetuesit të kolateralit, vetëm në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) kolaterali i njohur vlerësohet me çmimin e tregut;

b) pjesës së siguar/kolateralizuar të ekspozimit do t'i caktohej një peshë rreziku, e barabartë apo më e vogël se pesha e rrezikut që do t'i caktohej një ekspozimi të pasiguar ndaj personit/klientit, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

c) nuk ka mospërputhje midis maturitetit të ekspozimit dhe maturitetit të kolateralit.

KREU IV

MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 10

Kërkesat monitoruese dhe mbikëqyrëse

(Ndryshuar pika 8 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Bankat hartojnë dhe zbatojnë politika dhe procedura për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e ekspozimeve të mëdha, ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, që rrjedhin nga zërat në librin e bankës dhe librin e tregtueshëm.

2. Këshilli drejtues është përgjegjës, në veçanti, për vendimmarrjet në rastet e krijimit dhe ristrukturimit të ekspozimeve ndaj kredimarrësve të mëdhenj.

3. Bankat hartojnë procedura të plota administrimi dhe kontabiliteti, sisteme të përshtatshme informacioni dhe sisteme të përshtatshme të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e politikave dhe procedurave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Bankat hartojnë sisteme kontrolli të brendshëm për të parandaluar transferimet e përkohshme të ekspozimeve në fjalë, te një person tjetër dhe kryerjen e transaksioneve

joreale (fiktive) për të mbyllur ekspozimin dhe krijojnë një ekspozim të ri.

5. Bankat, për qëllime të përcaktimit të rrezikut të mundshëm të përqendrimit, hartojnë politika dhe procedura për identifikimin, analizimin dhe monitorimin e ekspozimeve, ndaj lëshuesve të mbrojtjes së kredisë dhe ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë dhe ekspozimeve në formën e obligacioneve të garantuara dhe ekspozimeve ndaj skemave.

6. Bankat kryejnë analizën e rrezikut të ekspozimit ndaj kredimarrësve të mëdhenj në momentin e krijimit të ekspozimit dhe në vazhdimësi, duke u bazuar në pasqyrat financiare të certifikuara/të audituara.

7. Bankat hartojnë plane të rimëkëmbjes dhe të zgjidhjes së kredimarrësve të mëdhenj dhe i rishikojnë ato me një frekuencë jo më të vogël se një herë në vit.

8. Bankat hartojnë dhe rishikojnë në bashkëpunim me njëra-tjetrën, planet e përbashkëta të rimëkëmbjes dhe të zgjidhjes, për kredimarrës/grup personash të lidhur, kur ekspozimi ndaj këtij kredimarrësi/grupi është ekspozim i madh, në të paktën një prej bankave.

Neni 11

Kërkesa raportuese

(Ndryshuar pika 1, ndryshuar fjalë në pikën 2, shtuar fjalë në pikën 3 me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Bankat, për qëllime raportimi dhe monitorimi, plotësojnë dhe dorëzojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë, formularin nr. 1, pjesë e aneksit 2, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, i cili përfshin informacionin e mëposhtëm:

a) raportimin e të gjitha ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj personave/klientëve individualë dhe grupeve të personave të lidhur, vlera e të cilëve, përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë, arrin ose tejkalon 10% të kapitalit rregullator të bankës, siç parashikohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) raportimin e të gjitha ekspozimeve të bankës ndaj personave/klientëve individualë dhe grupeve të personave të lidhur, vlera e të cilëve, përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë, arrin ose tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë të bankës;

c) raportimin e 20 ekspozimeve më të mëdha të bankës, pavarësisht nëse arrijnë/tejkalojnë ose jo 10% të kapitalit rregullator, përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë;

d) raportimin e 10 ekspozimeve më të mëdha të bankës ndaj institucioneve të mbikëqyrura, pavarësisht nëse arrijnë/tejkalojnë ose jo 10% të kapitalit rregullator, përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë;

e) raportimin e të gjitha ekspozimeve të bankës me rëndësi sistemike ndaj bankave me rëndësi sistemike dhe grupit të personave të lidhur me to, subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë;

f) raportimin e të gjitha ekspozimeve të bankës ndaj personave/grupeve të personave me marrëdhënie të veçantë me bankën;

g) raportimin e të gjitha ekspozimeve të bankës ndaj qeverive qendrore.

2. Grupi bankar raporton mbi baza të konsoliduara për ekspozimet maksimale të lejueshme dhe marrëdhëniet me personat e lidhur, *çdo 3-mujor (tremujor)*. Ky raportim kryhet sipas formularëve në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar".

3. Banka e Shqipërisë, në çdo rast që e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë dhe të urdhërojë ndryshime në përmbajtjen dhe në shpeshhtësinë e raportimit, nga sa parashikohet në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 12
Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, kur konstaton mosrespektimin, nga bankat, të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat administrative, mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore, të parashikuara në nenet 74 deri në 81 dhe në nenin 89 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13
Dispozitë e përkohshme

(Numërtuar paragrafi i parë dhe shtuar paragrafi i dytë me vendimin nr. 32, datë 2.7.2025)

1. Përjashtimisht nga përcaktimi i nenit 8, pika 2, shkronja “p”, të kësaj rregulloreje, ekspozimet në titujt e borxhit të Qeverisë Shqiptare në monedhë të huaj, që do të emetohen gjatë vitit 2020, nuk përfshihen në ekspozimin maksimal të lejueshëm.

Kjo dispozitë do të zbatohet deri në maturimin e këtyre titujve.

2. Parashikimet e shkronjës “q” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje do të zbatohen për të gjitha ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti që do të krijohen deri më 31 dhjetor 2026 dhe do të jenë të zbatueshme deri në afatin e miratuar të financimit, që në çdo rast ky i fundit nuk tejkalon 10 vjet.

ANEKS 1
TRAJTIMI I EKSPOZIMEVE NDAJ SKEMAVE
(Ndryshuar me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020)

1. Bankat i trajtojnë ekspozimet ndaj skemave duke konsideruar/vlerësuar ekspozimin ndaj skemës si një të tërë, ndaj aktiveve/ekspozimeve bazë (*underlying exposures*) të skemës ose të dyja së bashku (skemën dhe ekspozimet bazë).

2. Bankat, nëse identifikojnë ekspozimet bazë individuale në një skemë, monitorojnë rregullisht dhe të paktën në baza mujore, strukturën e ekspozimeve të skemës përkatëse.

Përcaktimi i kundërpartive përkatëse që do të merren në konsideratë

3. Banka e cakton shumën e ekspozimit ndaj vetë skemës, të cilën e identifikon si një kundërparti të veçantë, nëse vërteton se shumta e ekspozimit të bankës ndaj çdo aktivi bazë të skemës është më e vogël se 0.25% e kapitalit rregullator të bankës, duke konsideruar vetëm ato ekspozime ndaj aktiveve bazë që rezultojnë nga investimi në vetë skemën dhe duke përdorur vlerën e ekspozimit të llogaritur sipas paragrafëve 8 dhe 9³ të këtij aneksi. Në këtë rast, nuk është e nevojshme që banka të analizojë skemën nëpërmjet metodës *look through* për të identifikuar aktivet bazë.

4. Banka analizon skemën nëpërmjet metodës *look through*, për të identifikuar ato aktive bazë, për të cilat vlera e ekspozimit bazë është e barabartë ose më e lartë se 0.25% e kapitalit rregullator të bankës. Në këtë rast, identifikohet kundërpartia që i korrespondon secilit nga aktivet bazë, në mënyrë që këto ekspozime bazë t'i shtohen çdo ekspozimi tjetër të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj së njëjtës kundërpartie. Vlera e ekspozimit të bankës ndaj aktiveve bazë që janë nën 0.25% të kapitalit rregullator të bankës, mund t'i caktohet vetë skemës (pra banka mund të bëjë një analizë (*look through*) të pjesshme).

5. Nëse banka nuk është në gjendje të identifikojë aktivet bazë të një skeme, kur shumta totale e ekspozimit të saj ndaj skemës nuk tejkalon 0.25% të kapitalit rregullator, banka ia


³ Sipas përkufizimit, ky test konsiderohet i kaluar, nëse i gjithë investimi i bankës në një skemë është nën 0.25% të kapitalit rregullator.

cakton shumën totale të ekspozimit të investimit të saj vetë skemës. Në rast të kundërt, banka ia cakton këtë shumë totale të ekspozimit një personi “të paidentifikuar”.

Banka agregon të gjitha ekspozimet e paidentifikuara sikur të lidheshin me një kundërparti të vetme (person “i paidentifikuar”) dhe ekspozimi i bankës ndaj këtij personi “të paidentifikuar” nuk tejkalon kufirin e lejueshëm të ekspozimit të madh prej 20% të kapitalit rregullator.

6. Bankat, në asnjë rast, nuk mund të abuzojnë me zgjedhjen e mënyrës për trajtimin e ekspozimeve, me qëllim që të shmangin respektimin e kufijve për ekspozimin maksimal të lejueshëm, duke investuar në disa transaksione individuale jomateriale në aktive bazë identike, si dhe, në çdo rast, vërtetojnë se vendimi për të zbatuar një prej trajtimeve të parashikuara në këtë aneks është bërë në bazë të vlerësimit të natyrës ekonomike dhe rreziqeve që mbartin këto ekspozime/transaksione.

Metoda “Look – Through” – Diagrama e Vendimmarrjes



Llogaritja e ekspozimeve bazë - shuma e ekspozimit të bankës ndaj aktiveve bazë

7. Në rastet kur analiza (zbatimi i metodës *look through*) nuk është e nevojshme, ekspozimi i bankës ndaj skemës është sa shuma nominale që banka investon në skemë.

Skemat ku të gjithë investitorët renditen në të njëjtën shkallë përparësie *pari passu* (p.sh., Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive (SIK))

8. Në rastet kur analiza (zbatimi i metodës *look through*) është e nevojshme, në përputhje me paragrafët e mësipërm, vlera e ekspozimit ndaj një kundërpattie është e barabartë me përqindjen (*pro rata*) që banka mban në skemë, e shumëzuar me vlerën e aktivitetit bazë në skemë. Kështu, një bankë që zotëron 1% të aksioneve të një skeme që investon në 20 aktive, secili me një vlerë prej 5 njësisish, duhet të caktojë një ekspozim prej 0.05 për secilën nga kundërpattie. Banka i shton vlerën e ekspozimit ndaj një kundërpattie, çdo ekspozim tjetër të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që banka ka ndaj asaj kundërpattie.

Skemat me nivele të ndryshme senioriteti (përparësi në shlyerje) midis investitorëve (p.sh., entitete titullzimi)

9. Në rastet kur analiza (zbatimi i metodës *look through*) është e nevojshme, në përputhje me paragrafët e mësipërm, vlera e ekspozimit ndaj një kundërpattie matet për çdo segment (*tranche*) brenda skemës, duke supozuar një shpërndarje proporcionale *pro rata* të humbjeve midis investitorëve në një segment të vetëm. Për të llogaritur vlerën e ekspozimit ndaj aktivitetit bazë, banka:

- së pari, konsideron vlerën më të ulët midis vlerës së segmentit (*tranche*) në të cilin banka investon dhe vlerës nominale të çdo aktiviteti bazë të përfshirë në portofolin bazë të aktiveve; dhe

- së dyti, zbaton përqindjen (*pro rata*) e investimit të bankës në segment, mbi vlerën e përcaktuar në hapin e mësipërm.

Identifikimi i rreziqeve shtesë

10. Banka identifikon palët e treta që mund të përbëjnë një faktor shtesë rreziku, të lidhur me vetë skemën, se sa me aktivitetin bazë. Kjo palë e tretë mund të jetë një faktor rreziku për më shumë se një skemë, në të cilën banka investon. Palët e treta mund të jenë në rolin e origjinuesit, administruesit të fondit, ofruesit të likuiditetit dhe ofruesit të mbrojtjes së kredisë.

11. Identifikimi i një faktori shtesë rreziku ka dy ndikime:

- së pari, banka duhet të lidhë investimet e saj në ato skema, me një faktor të përbashkët rreziku, për të formuar një grup të kundërpattie të lidhura. Në këtë rast, administruesi i fondeve do të konsiderohet si një kundërpattie e veçantë, në mënyrë që shumica e investimeve të bankës në të gjitha fondet e administruara prej tij, të jetë subjekt i kufirit maksimal të lejueshëm të ekspozimeve të mëdha, ku vlera e ekspozimit do të jetë sa shumica e vlerave të investimeve të ndryshme. Por, në raste të tjera, administruesi mund të mos përbëjë një faktor shtesë rreziku - për shembull, nëse kuadri ligjor që parashikon rregullimin e fondeve të veçanta kërkon ndarje midis personit juridik që administron fondin dhe personit juridik që ka kujdestarinë e aktiveve të fondit.

Në rastin e produkteve financiare të strukturuar, ofruesi i likuiditetit ose promotori i programeve afatshkurtra (programi *ABCP* - *asset-backed commercial paper* dhe *SIV* - *structured investment vehicles*) mund të konsiderohen si një faktor shtesë rreziku, ku vlera e ekspozimit është sa shumica e investuar. Në mënyrë të ngjashme, në marrëveshjet sintetike⁴, ofruesit e mbrojtjes (shitësit e mbrojtjes me anë të garancisë/*credit default swaps*) mund të përbëjnë një burim shtesë rreziku dhe një faktor të përbashkët për ndërlidhjen e skemave të ndryshme (në këtë rast, vlera e ekspozimit do t'i korrespondonte vlerës në përqindje të portofolit bazë);

- së dyti, banka mund të shtojë investimet e saj në një grup skemash të lidhura me një palë të tretë, që përbëjnë një faktor të përbashkët rreziku për ekspozimet e tjera (të tilla si kredia) që ka ndaj palës së tretë. Nëse ekspozimet ndaj skemave të tilla duhet t'i shtohen ose jo ndonjë ekspozim tjetër ndaj palës së tretë, kjo do të varet nga shqyrtimi rast pas rasti i veçorive specifike të skemës dhe nga roli i palës së tretë. Në shembullin e

⁴ Marrëveshje sintetike janë marrëveshje/ kontrata për instrumentet financiare, që krijohen për të simuluar instrumente të tjera, ndërsa ndryshojnë karakteristikat kryesore. Shpesh, marrëveshjet sintetike iu ofrojnë investitorëve, modele të përshtatura të fluksit të parave, maturimit, profilit të rrezikut etj. Marrëveshjet sintetike janë të strukturuar për t'iu përgjigjur nevojave të investitorit.

administruesit të fondit, mund të mos jetë e nevojshme mbledhja e të gjitha ekspozimeve, sepse një sjellje potenciale spekulative nuk ndikon domosdoshmërisht në shlyerjen e një kredisë. Vlerësimi mund të jetë i ndryshëm kur rreziku për vlerën e investimeve bazë të skemave lind në rastin e dështimit të një pale të tretë. Për shembull, në rastin e një ofruesi të mbrojtjes së kredisë, burimi i rrezikut shitesë për bankën që investon në një skemë, është dështimi i ofruesit të mbrojtjes së kredisë.

Banka ia shton investimin në skemë ekspozimeve të drejtpërdrejta ndaj ofruesit të mbrojtjes së kredisë, pasi të dyja ekspozimet mund të përkthehen në humbje, në rast se ofruesi i mbrojtjes dështon (duke mos marrë parasysh se pjesa e garantuar e ekspozimeve mund të çojë në një situatë të padëshiruar të një ekspozimi të lartë ndaj rrezikut të përqendrimit ndaj emetuesve të kolateralit ose ofruesve të mbrojtjes së kredisë).

Nr.	Data e raportimit	Emri i bankës	Tipologjia e ekspozimit	Emërtimi i grupit të palëve të lidhura	Numri i klientit në varësi të tipologjisë së ekspozimit	Tipologjia Kontabile	Renditja e ekspozimeve	Renditja e ekspozimeve më të mëdha të bankës ndaj Institucioneve të Mbikëqyrura	Emri i klientit	NUIS / Numër Identifikimi	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLB)	Pozicionet në instrumente financiare (vetëm për ZLT)		
												Në blerje	Në shitje	Në blerje neto
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14 = 12 - 13
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														
28														
29														
30														
31														
32														
33														
34														
35														
36														

[illegible]

[illegible]

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË RAPORTIMIT NR. 1⁵

Numri i kolonës	Emri i Kolonës	Përshkrimi i përmbajtjes
1	Data e raportimit	Përzgjidhet data e raportimit sipas periudhës raportuese.
2	Emri i bankës	Përzgjidhet emri i bankës sipas shkurtimeve të mëposhtme. BA - Banka Alpha BAI - Banka Amerikane e Investimeve BBSH - Banka e Bashkuar e Shqipërisë BC - Banka Credins BKT - Banka Kombëtare Tregtare BPC - Banka ProCredit BPI - Banka e Parë e Investimeve BR - Banka Raiffeisen BT - Banka Tirana BU - Banka Union ISPB - Banka Intesa SanPaolo OTP - Banka OTP
3	Tipologjia e ekspozimit	Përmban kategorizimin e ekspozimit në varësi të kundërpartisë, siç është përcaktuar në këtë rregullore. Kolona do të plotësohet në bazë të kriterëve të parapërcaktuara. Lista e kategorizimit të kundërpartisë jepet më poshtë. Për secilin prej kundërpartive do të ketë një numër rendor për të dalluar kundërpartitë e së njëjtës tipologji. Kjo kolonë do të plotësohet për të gjitha ekspozimet. Në rastet kur më shumë se një ekspozim i përket një grupi të lidhur, për kodet GPL, GIML, GIMLB, GPLB, për secilin nga ekspozimet do të plotësohet i njëjti kod me të njëjtin numër rendor. Klient Individual Grup Personash të Lidhur Institucione të Mbikëqyrura Individuale Grup Institucioneve të Mbikëqyrura të Lidhura Institucione të Mbikëqyrura me marrëdhënie të veçantë (Lidhur) me Bankën Grup Institucioneve të Mbikëqyrura me marrëdhënie të veçantë (Lidhur) me Bankën Klient Individual me marrëdhënie të veçantë (Lidhur) me Bankën Grup Personash me marrëdhënie të veçantë (Lidhur) me Bankën Qeveri Qendrore Banka Qendrore ON & BShZh QR & AL & NJSP SIS Organizata Ndërkombëtare dhe Banka Shumëpalëshe të Zhvillimit Qeveri Rajonale, Autoritete Lokale dhe Njësi të Sektorit Publik Bankë Sistematike brenda vendit dhe grupi i personave të lidhur me të, që janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë
4	Emërtimi i grupit të palëve të lidhura	Vendoset një emërtim përmbledhës për grupin e palëve të lidhura dhe përsëritet i njëjti emërtim për çdo ekspozim individual të raportuar.
5	Numri i klientit në varësi të tipologjisë së ekspozimit	Përmban numrin e ekspozimit individual kur ai është pjesë e një grupi të lidhur. Kjo kolonë plotësohet vetëm për ekspozimet që në kolonën "Tipologjia e ekspozimit" kanë marrë kodin GPL, GIML, GIMLB, GPLB. Për verën e parë të çdo grupi, të zgjidhet opsioni "Total". Në vijim, për çdo ekspozim përbërës të grupit të zgjidhet nga një numër rendor, duke filluar nga numri 1, me qëllim identifikimin e numrit të ekspozimeve të grupit.
6	Tipologjia Kontabile	Përmban përcaktimin e natyrës kontabile të regjistruar duke ndarë zërat e librit të bankës dhe zërat e librit të tregtueshëm. Zë i Librit të Bankës Zë i Librit të Tregtueshëm Kjo zgjedhje bëhet kur ekspozimi ndaj klientit ose grupit i përmban të dy llojet e tipologjisë kontabile
7	Renditja e ekspozimeve	Përcaktohet renditja së cilës i përket ekspozimi. Renditja bëhet duke vendosur nr. 1 për ekspozimin më të madh të bankës, e kështu me rradhë. Referuar nenit 11 të rregullores, në këtë kolonë numri rendor duhet të arrijë të paktën 20, dhe më shumë se 20 nëse banka ka më shumë se 20 ekspozime të mëdha që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit rregullor të bankës dhe njëkohësisht ato që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit të nivelit të parë të bankës. Për rastet e grupeve të lidhura, për secilin prej ekspozimeve të të njëjtit grup, vendoset i njëjti numër rendor të cilit i korrespondon renditja e ekspozimit të grupit.
8	Renditja e ekspozimeve më të mëdha të bankës ndaj Institucioneve të Mbikëqyrura	Përcaktohet renditja së cilës i përket ekspozimi ndaj një institucioni të mbikëqyrur (përfshirë edhe ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura me marrëdhënie të veçantë me bankën). Renditja bëhet duke vendosur nr. 1 për ekspozimin më të madh të bankës ndaj institucionit të mbikëqyrur, e kështu me rradhë. Referuar nenit 11 të rregullores, në këtë kolonë numri rendor duhet të arrijë të paktën 10, dhe më shumë se 10 nëse banka ka më shumë se 10 ekspozime të mëdha ndaj institucioneve të mbikëqyrura që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit rregullor të bankës dhe njëkohësisht ato që tejkalojnë nivelin prej 10% të kapitalit të nivelit të parë të bankës. Për rastet e grupeve të lidhura të institucioneve të mbikëqyrura (me kodin GIML ose GIMLB), për secilin prej ekspozimeve të të njëjtit grup vendoset i njëjti numër rendor të cilit i korrespondon renditja e ekspozimit të grupit të institucioneve të mbikëqyrura.
9	Emri i klientit	
10	NUIS / Numër Identifikimi	Për çdo klient vendoset një numri identifikimi unik. Për rastet e ekspozimeve që janë të raportuara në regjistrin e kredisë, vendoset NUIS-i, i njëjti me atë të raportuar në regjistrin e kredive. Përndryshe banka vendos një numër identifikimi të vetën.
11	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLT)	Shuma e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje, e zmadhuar për shumën e ekspozimit, si rezultat i zëvendësimit, sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje (pjesë nga ekspozimi i garantuar nga një palë e tretë ose i siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, i cili është trajtuar si ekspozim ndaj garantuesit ose i lëshuesit të kolateralit), vetëm për zërat e librit të bankës.
12	Pozicionet në instrumente financiare (vetëm për ZLT)	Vlera e pozicioneve në blerje dhe në shitje, e të gjithë instrumenteve financiare, të lëshuar nga personi/klienti në fjalë, ku pozicionet neto, për secilin instrument financiar, janë përlogaritur në përputhje me rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" (Kreu VII - Rreziku i Tregut). Kur përlogaritet ekspozimi ndaj një personi/klienti individual si rezultat i pozicioneve në instrumente të ndryshme financiare, mbledhen pozicionet neto për instrumentet e ndryshme financiare të këtyre personave/klientëve. Kolonat 12, 13 dhe 14 plotësohen vetëm për zërat e librit të tregtueshëm.
13	Në blerje	Pozicioni në blerje në instrumente financiare
14	Në shitje	Pozicioni në shitje në instrumente financiare
15	Në blerje neto	Pozicioni në blerje neto në instrumente financiare
15	Pozicionet në instrumente financiare në rast të nënshkrimit me premtimin për të blerë (vetëm për ZLT)	Shuma e ekspozimit që lind nga angazhimi për të blerë instrumente financiare të personave/klientëve individualë, në rastin e përgatitjes dhe finalizimit të nënshkrimit, e reduktuar për shumën e instrumenteve financiare, të cilët u janë transferuar tashmë, palëve të treta dhe ekspozimi neto i përlogaritur (diferenca). Kolonat 15, 16 dhe 17 plotësohen vetëm për zërat e librit të tregtueshëm.
16	Premtimi për të blerë	Angazhimi/premtimi për të blerë
17	Transferuar një personi të tretë	Shuma e instrumenteve financiare, të cilët u janë transferuar palëve të treta
18	Diferenca	Ekspozimi neto i përlogaritur
18	Ekspozimi i rrezikut të kredisë së kundërpartisë (vetëm për ZLT)	Ekspozimet ndaj një personi/klienti individual, si rezultat i transaksioneve, marrëveshjeve ose kontratave, që lidhen me rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të përlogaritura në përputhje me metodat e parashikuara në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".
19	Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (vetëm për ZLT)	Shuma e ekspozimeve të paraqitura në kolonat 14, 17 dhe 18, për zërat e librit të tregtueshëm.

⁵ Sipas shkronjës c) të pikës 1 të Vendimit nr. 32, datë 2.7.2025 ndryshon përshkrimi i kolonës nr. 27, në udhëzuesin shpjegues për plotësimin e formularit nr. 1, sipas përmbajtjes së mëposhtme;

"Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat "a", "b", pjesërisht shkronjën "d", pjesërisht shkronjën "e" dhe shkronjat "h", "i", "j", "l", "m", "n", "p" dhe "q", të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje."

20	Ekspozimi i përgjithshëm përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (ZLB+ZLT)	Totali i kolonave 11 dhe 19 (për zërat e librit të bankës dhe të librit të tregtueshëm).
21	Nga i cili (20): Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë i ardhur nga zëvendësimi	Pjesa e ekspozimit e garantuar nga një palë e tretë ose e siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila trajtohet si një ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit - përdorimi i zëvendësimit në përputhje me nenin 9 të rregullores (shuma e përfshirë në kolonën 20).
22	Nga i cili (20): Ekspozimi përpara përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë i ardhur nga shuma e kredive (vetëm për ekspozimet e kategorive IMLB, GIMLB, KILB dhe GPLB)	Do të plotësohet vetëm për vlerën e ekspozimit, të raportuar në kolonën 20, në formën e kredisë ndaj kategorive IMLB, GIMLB, KILB dhe GPLB, në kuptim të nenit 131 të ligjit për bankat.
23	Përqindja ndaj kapitalit rregullator përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 20, në raport me kapitalin rregullator të bankës në datën e raportimit.
24	Përqindja ndaj kapitalit të nivelit të parë përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 20, në raport me kapitalin e nivelit të parë të bankës në datën e raportimit.
25	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Shuma e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, e cila, në përputhje me shkronjën "c", pjesërisht me shkronjën "d" dhe pjesërisht me shkronjën "e", të pikës 2 të nenit 8 dhe pikën 2 të nenit 9 të kësaj rregulloreje, mund të përdoret për të përcaktuar nëse janë arritur kufijtë maksimale të lejueshëm të ekspozimit.
26	Mbrojtja e financuar e kredisë	Shuma e mbrojtjes së financuar të kredisë e cila, në përputhje me shkronjat "f" dhe "g" të pikës 2 të nenit 8 dhe pikës 3 të nenit 9 të kësaj rregulloreje, mund të përdoret kur përcaktohet nëse janë arritur kufijtë maksimale të lejueshëm të ekspozimit.
27	Përjashtime dhe reduktime	Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat "a", "b", pjesërisht shkronjën "d", pjesërisht shkronjën "e" dhe shkronjat "h", "i", "j", "l", "m", "n" dhe "p", të pikës 2 të nenit 8.
28	Ekspozimi pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë për ZLB	Vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, pas reduktimeve, përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, për zërat e librit të bankës.
29	Ekspozimi i përgjithshëm pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të përgjithshëm (për zërat e librit të bankës dhe të librit të tregtueshëm), e llogaritur në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, pas reduktimeve, përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë.
30	Kapitali rregullator i bankës në datën e raportimit	Shuma e kapitalit rregullator të bankës në datën e raportimit.
31	Kapitali i nivelit të parë të bankës në datën e raportimit	Shuma e kapitalit të nivelit të parë të bankës në datën e raportimit.
32	Përqindja ndaj kapitalit rregullator, pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 29, në raport me kapitalin rregullator të bankës në datën e raportimit.
33	Përqindja ndaj kapitalit të nivelit të parë, pas përjashtimeve, reduktimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Vlera e ekspozimit të raportuar në kolonën 29, në raport me kapitalin e nivelit të parë të bankës në datën e raportimit.
34	Kufiri maksimal i lejueshëm	Në këtë kolonë përcaktohen kufijtë maksimalë të lejueshëm të ekspozimeve, në varësi të natyrës së ekspozimit të përcaktuar në kolonën 3.
35	Tejkalimet e kufirit maksimal të lejueshëm	Kjo kolonë plotësohet automatikisht vetëm nëse ekspozimi tejkalon kufirin maksimal të lejueshëm.
36	Ekspozimet e mëdha që janë mbi 10% e kapitalit rregullator të bankës	Në këtë kolonë do të evidentohen automatikisht të gjitha ekspozimet e mëdha (kolona 29) që tejkalojnë 10% të kapitalit rregullator të bankës.
37	Matja e shumës së ekspozimeve të mëdha që janë mbi 10% e kapitalit rregullator të bankës	Në këtë kolonë do të bëhet vlerësimi automatik i: a) Shumës së ekspozimeve të raportuara në kolonën 36; b) Raporti i kësaj shume me kapitalin rregullator të bankës; c) Vlerësimi i respektimit të kufirit maksimal prej 700% të shumës së katër ekspozimeve ndaj kapitalit rregullator të bankës.
38	Matja e ekspozimeve të kredive për kategoritë e kundërpartive të lidhura me bankën (IMLB, GIMLB, KILB dhe GPLB)	Në këtë kolonë do të bëhet vlerësimi automatik i: a) Shumës së kredive të raportuara në kolonën 22; b) Raporti i kësaj shume me kapitalin rregullator të bankës; c) Vlerësimi i respektimit të kufirit maksimal prej 100% të shumës së katër kredive ndaj kapitalit rregullator të bankës.